

VENDIM
Nr. 1031, datë 27.11.2013

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 17 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, bëhet rishpërndarja e fondeve si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 09240 “Arsimi i mesëm profesional”, shpenzime kapitale, financim i huaj, të zbritet fondi prej 42 000 000 (dyzet e dy milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 09450 “Arsimi i lartë”, shpenzime kapitale, financim i huaj, të zbritet fondi prej 7 664 422 (shtatë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e njëzet e dy) lekësh.

c) Në programin buxhetor 09120 “Arsimi bazë”, shpenzime kapitale, financim i huaj, të shtohet fondi prej 37 985 693 (tridhjetë e shtatë milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tre) lekësh.

ç) Në programin buxhetor 09230 “Arsimi i mesëm i përgjithshëm”, shpenzime kapitale, financim i huaj, të shtohet fondi prej 11 678 729 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama